

**Data 27.02.2023**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

Loti I: Supervizim „Sistemim asfaltim rruga e Fermentimit Hotajve dhe Kurtaj ne lagjen Palvar“.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):71247000-1

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

223 571 (dyqind e njetet e tri mije e peseqind e shtatedhete e nje)leke pa tvsh.Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Malesi e Madhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit dhe kualifikimit.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

a) Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit (2019 - 2020 - 2021) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet qe te tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet . Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nese dy bilance te njepasnjeshme nuk kane raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet..

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të

ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

b) Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019 - 2020 - 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet. .

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" etj.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme ofertuesi duhet të dorezojë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara (sipas shtojcës nr.9).
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 20 % të vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet për shërbime të ngjashme të kryera në 3 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit

88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë ( e vlefshme) për Mbikqyrje dhe Kolaudim te Punimeve te Zbatimit (leshuar nga Ministria perkatese, sipas legjislacionit ne fuqi) me kategorite e meposhtme:

- NP- 1
- NP- 4
- NS- 1
- NS-18

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë perkatese sipas legjislacionit ne fuqi, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, vkm nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, "për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" si dhe pika 4, neni 41 I VKM 285/2021. Kategoritë janë kërkuar bazuar ne preventivin e punimeve te objektit qe do te mbikeqyret dhe konkretisht :

Nr.	Kategoria e lic.	Zerat ne preventiv
1	NP- 1	Seksioni ” Punime Germimi” :Zeri nr.1,2
2	NP- 4	Sipas llojit te objektit- <b>Rrugë</b> autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.
3	NS- 1	Seksioni ” Punime te ndryshme” :Zeri nr.2.
6	NS-18	Sipas llojit te objektit, i nevojshem per rilevimin e rruges

2.3.3. Ofertuesi duhet te kete drejtues teknik ne licencen profesionale të shoqërisë ( e vlefshme) për Mbikqyrje dhe Kolaudim te Punimeve te Zbatimit, te pakten:

- a. 1 (nje) Ing. Ndertimi
- a. 1 (nje) Ing. Gjeodet

Per kete, ofertuesi duhet te paraqese kontraten e punes, diplomen/licence dhe CV.

**Argumentimi:** : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikes 4, neni 41 I VKM 285/2021. Drejtuesit teknike te kerkuar ne piken 2.3.3. kerkohen ne perputhje me kategorite e licencave te kerkuara ne piken 2.3.2.

2.3.4.Një punësim mesatar i të paktën 4 (kater) personave, për periudhën Nentor 2022 – Janar 2023 të vërtetuar me:

-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per periudhen perkatese;

-Listë pagesat e punonjesve për periudhën perkatëse të konfirmuar nga Administrata Tatimore (ne forme elektronike);

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka llogaritur dy inxhinieret që kërkohen në pikën 2.3.3 si dhe 2 ndihmes sipas rastit.

**2.3.5. Operatorët ekonomik duhet të disponojnë certifikatat:**

ISO 9001: 2015 “Per menaxhimin e cilesise”

ISO 45001-2018 “Sistemet e menaxhimit të sigurise dhe shendetit në pune”.

*Certifikatat duhet të jene ne gjuhen e ofertes, dhe ne perputhje me natyren e objektit qe tenderohen. Ne rast bashkimi operatoresh, keto certifikata duhet ti kete secili operator ekonomik ne baze te perqindjes se realizimit te kontrates qe merr perisiper ne akt-marreveshje.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.3.6. Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshitllit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.**

**Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vleres minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”**

**Argumentimi:** : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në njoftimin Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshitllit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**